



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË
BULETINI SHKENCOR**

FORMATI I ARTIKULLIT

Punimi duhet të shkruhet në Microsoft® Office Word 2007, i formatuar në **letër A4**, me një hapësirë 4.5cm nga të gjitha anët, fonti duhet të jetë Times New Roman, single line (vijëzimi justified), me font 12, hapësira midis rreshtave 1.15. Artikulli i formatuar sipas këtyre udhëzimeve, bashkë me formulat, tabelat, figurat dhe fotografitë duhet të jetë jo më pak se 6 faqe dhe jo më shumë se 10 faqe.

Autori duhet të shkruajë si rregull në vetën e tretë duke përdorur shprehje si: quhet, konsiderohet, arrihet në përfundim se, vërtetohet se etj.

Në Buletin mund të publikohen informacione përmbledhëse në më pak se 4 (katër) faqe si: Informacion Shkurt, Diskutim, Përmbledhje Libri, Njoftim.

Në një punim janë të detyrueshëm elementët e mëposhtëm:

- **Titulli,**
- **Autori(ët)** në një rresht,
- **Adresa(t)** përkatëse korresponduese
- **Përmbledhja/abstrakti** (në 2(dy) gjuhë shqip/anglisht)
- **Fjalët kyç,**
- **Konkluzionet,**
- **Referencat.**

Rekomandohet që në strukturën e një punimi të konsiderohet edhe elementet e mëposhtem:

- **Hyrja,**
- **Sfondi teorik**
- **Formulimi i problemit dhe qëllimeve të hulumtimit**
- **Pyetjet dhe hipoteza**
- **Materiali dhe metodat,**
- **Rezultatet dhe diskutimet,**

Titulli: Titulli i punimit duhet të jetë i shkurrë, i qartë dhe informues. Titulli duhet të shtypet me gërma KAPITALE me font 14 dhe me bold. Titulli, autori(t) dhe adresat vendosen në qendër. Titulli duhet të përkohë me përmbajtjen e vërtetë të temës. Duhet shmangur fjalët/shprehjet e përgjithshme (abstrakte) dhe duhet të formulohet një titull konkret dhe specifik për fushën e studimit. Pas tij vendosen emrat e autorëve, institucionet përkatëse dhe adresat e plotë të tyre, grada apo titulli shkencor i autorëve. Kur punimi është me dy ose me shumë autorë, emri i autorit që do të mbajë korrespondencën duhet të ketë një asteriks.

Përmbledhja/abstrakti: Paraqet thelbin e punimit dhe përfundimet që arrihen në të.

Përmbledhja duhet të paraqitet në dy gjuhë, anglisht dhe shqip. Ajo nuk duhet të jetë më shumë se 20 rreshta për secilën nga gjuhët. Abstrakti duhet të pasqyrojë vetëm atë çfare shfaqet origjinale në punimin tuaj. Në abstrakt nuk lejohen shënimet dhe referencat.

Fjalët kyç: Punimi duhet të ketë jo më shumë se 4-6 fjalë kyç të cilat pasqyrojnë thelbin e punimit.

Hyrja: Në hyrje bëhet një paraqitje e hollësishme e rëndësisë së problemit që do të jetë në qendër të punimit. Hyrja duhet të përshkruajë shkurt bazën për punën e paraqitur. Në hyrje tregohen objektivat dhe arsyet e ndërmarrjes së studimit, struktura e punimit si dhe shkurtimisht rezultatet e marra, diskutimet e kryera dhe të rejtat që sjell punimi.

Sfondi teorik: Në këtë pjesë bëhet një përshkrim i përgjithshëm i “fushës së studimit” dhe vendoset tema e propozuar. Në punën kërkimore gjithnjë fillohet prej një baze teorike që është mbizotëruese në një fushë të caktuar shkencore. Konceptet teorike të autorëve/shkencëtarëve të njohur, duhet të jene brenda një 10 vjeçari.

Formulimi i problemit dhe qëllimeve të punimit: Problemi shkencor duhet të përkufizohet qartë, saktë dhe mirë. Qëllimet e punimit duhet të jenë të harmonizuara me problemin. Parashtrimi i problemit edhe nëse ai qëndron si i tillë, duhet të jenë të lidhura kuptimisht me qasjen teorike, por edhe me hipotezat dhe metodat e parashikuara të kërkimit.

Pyetjet dhe hipoteza: Pyetja e punimit duhet të formulohet qartë. Ajo duhet të nënkuptojë një hipotezë kërkimi që mund të verifikohet. Hipoteza e kërkimit duhet të jetë e formuluar saktë, në mënyrë që të shmanget dykuptimësia dhe kërkesat shtesë. Është e rëndësishme që gjetjet të paraqiten në mënyrë të tillë që mund të arrihet në përfundime. Në kërkimet cilësore është e rëndësishme që të kuptohen drejt dukuritë e hulumtuara dhe të tregohet se përvojat që pasqyrohen në to ndihmojnë të kuptuarit dhe lejojnë mbërritjen në përfundime të caktuara. Nëse përdorim kërkime sasiore apo një përzierje të të dyjave, është gjithashtu e rëndësishme të përcaktohet një numër kriteresh përmes së cilave një hipotezë pohohet ose mohohet.

Materiali dhe Metoda duhet të paraqiten në mënyrë të detajuar. Këtu paraqiten metodat e ndryshme të përdorura në studim si dhe ato statistikore. Informacioni duhet të jetë i mjaftueshëm që të lejojë referimet.

Rezultatet dhe diskutimet duhet të jenë të qarta dhe të ilustruara në tabela dhe grafikë. Rezultatet eksperimentale duhet të analizohen statistikisht dhe të nxirren përfundime në bazë të një besueshmërie statistikore. Të njëjtat rezultate të dhëna me tabela nuk mund të jepen edhe me anën e grafikëve dhe anasjelltas.

Konkluzionet: Konkluzionet që vijnë nga rezultatet e paraqitura duhet të diskutohen në mënyrë të plotë, të lidhen direkt dhe të mbështeten në rezultatet e arritura. Konkluzionet nuk duhet të jenë spekulative, të merren prej literaturës, njohurive të përgjithshme e spontane.

Referencat: Burimet e literaturës duhet të listohen në mënyrë alfabetike në bazë të mbiemrit të autorit të parë. Referencat duhet të vendosen në fund të punimit. Çdo burim i përmendur në shkrim duhet të pasqyrohet në bibliografi dhe anasjelltas, burimet e dhëna në bibliografi duhet t'u përgjigjen citimeve të bëra gjatë punimit. Disa rregulla bazë:

1. Bibliografia shkruhet sipas renditjes alfabetike të mbiemrave të autorëve të caktuar. Kur ka më shumë se një autor, burimi renditet alfabetikisht në bazë të mbiemrit të autorit të parë.
Alushi, B. (1980). Titulli i librit. Vendi i botimit: Shtëpia botuese
Kane, Thomas. (2010) Si të shkruajmë shqip. Tiranë: Qendra për arsim demokratik, 238-240
2. Nëse keni më shumë se një burim nga i njëjti autor, për renditjen e veprave të tij perdoret viti i botimit, duke vënë veprën më të hershme në fillim. Në qoftë se edhe viti është i njëjtë, atëherë renditni alfabetikisht sipas shkronjës së parë të titullit të artikullit/ librit dhe përdorni shkronja mbas vitit, për shembull (1980a) dhe (1980b).
Alushi, B. (1980a) Arsimi shqiptar. Tiranë: Shtëpia Botuese X.
Alushi, B. (1980b) Konstruktivizmi në arsim. Tiranë: Shtëpia Botuese X.
3. Në qoftë se burimi nuk ka autor, atëherë renditni alfabetikisht në bazë të shkronjës së parë të titullit të veprës ose institucionit që e ka botuar.
Enciklopedia rinore (1980). Tiranë: Shtëpia Botuese X.
Instituti i Statistikave (2008), Vjetari Statistikor. Tiranë: Shtëpia Botuese X.
4. Autorëve të huaj duhet t'i lihet emri siç është në gjuhën origjinale, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të bëhet i mundshëm kërkimi i burimit. Po kështu edhe titulli i librit/ burimit duhet vendosur në origjinal dhe në kllapa përkthimi i tij.
Gowers, E. (1986). Plain words (Shkrimet administrative). Londër: Penguin Books
5. Kur burimi nuk është një libër, si në shembujt e mësipërm, por një artikull i marrë nga një revistë shkencore ose nga një vëllim-përmbledhje, modeli është si më poshtë:
Revistë:
Ademi, M. (1990). Konstruktivizmi në arsim. Revista pedagogjike, Nr. 4, faqe 15- 21.
Përmbledhje artikujsh/ kapitull i një libri:
6. Burimet nga interneti duhen dhënë me adresën e tyre të plotë, nën një nëntitull të veçantë 'Burime nga interneti':

<http://www.bbc.co.uk/albanian/regin>

Tabelat: Çdo tabelë duhet të ketë numrin si dhe titullin e saj

Figura ose Grafikë: Dorëshkrimi mund të përmbajë figura ose/dhe grafikë. Figurat dhe grafikët duhet të kenë numra dhe tituj.

**DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË
BULETINI SHKENCOR**